



Republika e Maqedonisë së Veriut

AGJENCIA TEKNIKE OPERATIVE SHKUP

OTA

Бр. 08-128/1  
22.02.2021

ota@ota.mk

RAPORT VJETOR  
PËR PUNËN E AGJENCISË TEKNIKE OPERATIVE SHKUP PËR VITIN  
2020

Shkup, shkurt, 2021



Republika e Maqedonisë së Veriut

AGJENCIA TEKNIKE OPERATIVE

DREJTUAR: Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut  
Bulevar 11 Tetori 10, 1000 Shkup

Për z. Talat Xhaferi, kryetar i Kuvendit të RMV

22.02.2021

Lënda: Dorëzimi i Raportit vjetor për punën e ATO për vitin 2020

www@ota.mk

Të nderuar,

Drejtori i Agjencisë Teknike-Operative Shkup (më tutje:ATO) miratoi Raport vjetor për punën e ATO për vitin 2020 të verifikuar në ATO me numër 08-128/1 prej 22.02.2021.

Në bazë të nenit 7 të Ligjit të Agjencisë Teknike-Operative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 71/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 98/19 - më tutje në tekstin: LATO), në shtojcë të kësaj shkrese në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut e dorëzojë për shqyrtim Raportin vjetor për punën e ATO për vitin 2020 të verifikuar në ATO 08-128/1 prej 22.02.2021.

Mbetem në dispozicion për të gjitha pyetjet e nevojshme dhe arsyetime.

Shtojcë: Raport vjetor për punën e ATO për vitin 2020 të verifikuar në ATO me numër 08-128/1 prej 22.02.2021.

Me respekt,

ДИРЕКТОР,  
Зоран Ангеловски



Изработено во 2 примероци, и доставено до:

- Писарница на ОТА
- Собрание на Република Северна Македонија



## Republika e Maqedonisë së Veriut

### AGJENCIA TEKNIKE OPERATIVE

Në bazë të nenit 7 të Ligjit për Agjencinë Teknike-Operative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 71/18 dhe "Gazeta zyrtare e Republikës së Veriut Maqedonisë" nr. 98/19 - më tutje në tekst: LATO), drejtori i Agjencisë Teknike-Operative Shkup (në tekstin e mëtutjeshëm - ATO), e miratoi këtë:

### RAPORT VJETOR PËR PUNËN E AGJENCISË TEKNIKE OPERATIVE SHKUP PËR VITIN 2020

#### I. HYRJE

Agjencia Teknike-Operative është organ shtetërorë i pavarur dhe i mëvetësishëm, i themeluar me Ligjin për Agjencinë Teknike-Operative, me të cilin ligj përveç themelimit të ATO, rregullohen edhe kompetencat, udhëheqja, të drejtat dhe obligimet e marrëdhënies së punës të punëtorëve në ATO, mbikëqyrja profesionale dhe financimi i ATO.

Në pajtim me dispozitat ligjore, drejtori i ATO e dorëzon për shqyrtim në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut këtë raport për punën e ATO për vitin paraprak 2020.

#### II. NUMRI I KOMUNIKIMEVE TË AKTIVIZUARA PËR NEVOJAT E ORGANEVE TË AUTORIZUARA

Gjatë vitit 2020, për nevojat e organeve të autorizuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ATO teknikisht ndërmjetësonte në:

475 aktivizime të reja të masës ndjekje të komunikimeve dhe 378 vazhdime të masës ndjekje të komunikimeve

#### III NUMRI I KOMUNIKIMEVE TË AKTIVIZUARA PËR ÇDO ORGAN TË AUTORIZUAR VEÇMAS

Nga numri i përgjithshëm i theksuar nga 475 aktivizime të reja të masës ndjekje të Komunikimeve me ndërmjetësim teknik të ATO në vitin 2020:

321 aktivizime të masës ndjekje të komunikimeve ishin për nevojat e MPB dhe

68 aktivizime të masës ndjekje të komunikimeve ishin për nevojat e Prokurorisë Publike.

Nga 378 vazhdime të theksuara të masës ndjekje të komunikimeve me ndërmjetësim teknik të ATO në vitin 2020:

104 vazhdime të masës ndjekje të komunikimeve ishin për nevojat e MPB dhe

36 vazhdime të masës ndjekje të komunikimeve ishin për nevojat e Prokurorisë Publike.



Republika e Maqedonisë së Veriut

AGJENCIA TEKNIKE-OPERATIVE

IV. GJENDJA DHE KONSTATIME GJATË MBIKËQYRJEVE PROFESIONALE TË REALIZUARA NGA ATO MBI PUNËN E OPERATORËVE

Gjatë vitit 2020 dhe në përputhje me aktivitetet rrjedhëse për kryerjen e kompetencave ligjore, Agjencia Teknike-Operative në vazhdimësi zbatonte këqyrje të planifikuara dhe të jashtëzakonshme në punën e operatorëve të lidhur me plotësimin e kushteve teknike dhe masave dhe standardeve të zbatuara të parapara me ligj.

Projektet rrjedhëse të ATO për mbindërtimin e sistemit për ndjekje të komunikimeve dhe punët të cilat zhvilloheshin për realizimin e tyre mundësuan hulumtimin sistemor dhe kontrollimin e gjendjeve të elementeve të rrjetit të cilat janë pjesë e procesit të ndjekjes së komunikimeve të operatorët Telekom dhe A1. Në kuadër të aktiviteteve të përmendura, personat kompetent të ATO kishin mundësi ta shikojnë infrastrukturën e disponueshme, plotësimin e kushteve teknike dhe masat e zbatuara të parapara me ligj dhe aktet nënligjore. Në pajtim me të përcaktuarën, janë dorëzuar kërkesa të operatorët për veprim dhe mundësim të kushteve teknike që i imponon progresi teknologjik në sferën e telekomunikimeve dhe ligjeve referente.

Gjithashtu, në vitin 2020 është bërë skringing i gjendjeve edhe të operatorët telekomunikues "Telekabel" dhe "Neotel" nga aspekti i kapacitetit për përgjigje të plotë të obligimeve ligjore. Në atë kuptim janë përcaktuar elementet për infrastrukturën momentale të rrjetit dhe servise që i ofrojnë operatorët më të vegjël në pajtim me nevojat për optimizim të funksionalitetit për zbatimin e masës hulumtuese të veçantë ndjekje të komunikimeve. Me kërkesë të ATO është dorëzuar dizajni i plotë i implementimit të zgjidhjes adekuate teknike për ndjekje të komunikacionit dhe ndryshime zhvillimore të cilat do ta afektonin procesin e ndjekjes së komunikimeve. Të operatorët e vegjël, gjithashtu si dhe të mëdhenjtë, ishin kontrolluar gjendjet me siguri informative dhe personale - në nivel të plotësimit të kushteve të parapara me ligj dhe aktet nënligjore, dhe ishin ndërmarrë aktivitete për plotësimin e tyre në tërësi.

V. NUMRI I PROCEDURAVE DISIPLINORE TË ZBATUARA PËR PUNËTORË NË ATO

Gjatë vitit 2020 në ATO u zbatuan (përfunduan) gjithsej 4 (katër) procedura disiplinore



## Republika e Maqedonisë së Veriut

### AGJENCIA TEKNIKE OPERATIVE

#### VI. PUNA FINANCIARE E ATO

Financimi i Agjencisë Teknike-Operative është rregulluar me nenin 33 të LATO dhe nenin 29-a të Ligjit për komunikime elektronike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 39/14, 188/14, 44/15, 193/15, 11/18, 21/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 98/19 dhe 153/19), më tutje: LKE). Në pajtim me LKE, AKE është e detyruar shumat e parapara të përcaktuara në raportin vjetor për punën e AKE për vitin kalendarik paraparak të miratuar nga Komisioni i AKE, t'i paguajë ATO më së voni deri më 15 prill në vitin vijues.

Në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2020 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 265/2019) Agjencisë Teknike-Operative i ishte siguruar buxhet i përgjithshëm për vitin 2020 në shumë prej 166.802,00 denarë nga të cilat:

- shpenzime të buxhetit themelorë në shumë prej 93.975.000,00 denarë dhe
- shpenzime nga aktivitete vetëfinancuese (kompensime nga AKE në pajtim me LKE) në shumë prej 72.827.000,00 denarë.

Për shkak të epidemishë së shpallur pandemike nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, ndërsa për shkak të parandalimit të futjes dhe përhapjes dhe ballafaqimit me Koronavirusin Covid-19, më 18.03.2020, me Vendim për përcaktimin e ekzistimit të gjendjes së jashtëzakonshme të botuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 68/20 ishte shpallur gjendje e Jashtëzakonshme në tërë territorin e shtetit. Gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së jashtëzakonshme, Qeveria e RMV në pajtim me Kushtetutën dhe me ligj miratoi dekrete me fuqi ligjore të cilat ishin drejtpërdrejtë të zbatueshme.

Qeveria e RMV miratoi Dekret me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për buxhete gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 79/20). Në bazë të këtij Dekreti sipas të cilit Qeveria e RMV vendos për rishpërndarjet ndërmjet shfrytëzuesve buxhetorë të pushtetit qendrorë dhe ndërmjet fondeve, me propozim të Ministrisë së Financave, Qeveria e RMV miratoi Vendim për rishpërndarjen e mjeteve ndërmjet shfrytëzuesve buxhetorë të pushtetit qendrorë dhe ndërmjet fondeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 97 prej 09.04.2020. Me këtë Vendim, Agjencisë Teknike-Operative shpenzimet nga zëra të caktuar nga buxheti i paraparë për vitin 2020 i janë zvogëluar në shumë të përgjithshme prej 50.250.000,00 denarë, që paraqiste zvogëlim prej 55,47% të mjeteve të përgjithshme të cilat nga buxheti i RMV i janë miratuar si shpenzime të buxhetit themelorë për ATO për vitin 2020, përkatësisht zvogëlim prej 30,13% nga buxheti i përgjithshëm i ATO për vitin 2020.

Agjencia për komunikime elektronike në bazë të Dekretit me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për komunikime elektronike gjatë gjendjes së jashtëzakonshme ("Gazeta Zyrtare e RMV" numër 169/2020 prej 22.06.2020) më 24.06.2020 ATO për vitin 2020 i pagoi shumë prej 64.000.000,00 denarë.



Република Северна Македонија

AGJENCIA TEKNIKE-OPERATIVE

Со Изменувањето и дополнувањето на Буџетот на Република Северна Македонија за Ме ndryshimin dhe plotësimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 262/20 prej 04.11.2020) buxheti i përgjithshëm i ATO për vitin 2020 u zvogëluar në shumë prej 129.352.000,00 denarë nga të cilat:

- shumë prej 43.825.000,00 denarë janë shpërndarë si shpenzime të buxhetit themelorë dhe
- shumë prej 85.527.000,00 denarë janë shpërndarë si shpenzime nga aktivitete vetë financuese (kompensime nga AKE në pajtim me LKE).

Nga mjetet e përgjithshme të miratuara në Buxhetin e ATO për vitin 2020 nga Agjencia Teknike-Operative u realizuan mjete në shumë të përgjithshme prej 80.934.566,00 denarë, gjatë së cilës nga mjetet e buxhetit themelorë janë realizuar 42.618.212,00 denarë, ndërsa nga aktivitetet vetë financuese janë realizuar 38.316.354,0 denarë. Pjesa e mbetur e mjeteve nga shpenzimet e aktiviteteteve vetë financuese në shumë të disponueshme sipas ekstraktit të fundit prej 49.082.632,00 denarë në pajtim me nenin 37 - b paragrafi 6 të Ligjit për buxhetet (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 64/05, 04/08, 103/08, 156/09, 95/10, 180/11, 171/12, 192/15 dhe 167/16) në fund të vitit fiskal transferohen në vitin e ardhshëm 2021.

Realizimi i mjeteve të ATO për vitin 2020 të shpërndara sipas zërave:

Numri rendor	Zëri	Shuma të realizuara sipas zërave në denarë
1.	401-20	19.669.213,00
2.	402-20	9.434.557,00
3.	420-20	84.794,00
4.	421-20	1.725.084,00
5.	423-20	299.961,00
6.	424-20	19.045.576,00
7.	425-20	8.866.662,00
8.	426-20	1.105.009,00
9.	480-20	1.635.993,00
10.	481-20	537.372,00
11.	483-20	0,00
12.	485-20	18.530.345,00



Republika e Maqedonisë së Veriut

AGJENCIA TEKNIKE OPERATIVE

VII. PUBLIKIM

Ky raport vjetor për punën e ATO për vitin 2020 dorëzohet për shqyrtim në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, më së voni deri në fund të shkurtit 2021 dhe i njëjti publikohet në vend të dukshëm në internet faqen e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

AGJENCIA TEKNIKE-OPERATIVE SHKUP

DREJTOR  
Zoran Angelovski